

## Shtojca 13

### AGJENCIA E SHËRBIMEVE FUNERALE FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Nr.363/9 prot.

Date 22.05.2020

Për: Operatorin ekonomik “**SHPRESA-AL**”sh.p.k.

Adresa: Njësia Bashkiake Nr.9, Rruga "Urani Pano", mbrapa "Veve Center", Pallati Nr.11, Kati 2, e-mail: [shpresa.al@gmail.com](mailto:shpresa.al@gmail.com)

Procedura e prokurimit: Kërkesë për propozime

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-56790-04-24-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Blerje materiale ndertimi,si: rere, çimento, çakull, granil, hekur etj per nevoja te agjencise. Afati fillon nga data e nënshkrimit të kontratës dhe përfundon më datë 31.12.2020.

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike: nr.24, date 04.05.2020

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Op.ekonomik “**SHPRESA-AL**”sh.p.k.

K31321021N

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Vlera **3 929 500** (tre milion nëntëqind e njëzet e nëntë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH.

*(me numra dhe fjalë)*

2. Op.ekonomik “**EURO-ALB**”sh.p.k.

K66613407H

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Vlera **3 991 500** (tre milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e një mijë e pesëqind) lekë pa TVSH.

*(me numra dhe fjalë)*

3. Op.ekonomik “**SARK**”sh.p.k.

K52531415H

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Vlera **4 126 000** (katër milion e njëqind e njëzet e gjashtë mijë) lekë pa TVSH.

*(me numra dhe fjalë)*

4. Op.ekonomik “**PAERA**”sh.p.k.

L31505034R

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Vlera **4 144 500** (katër milion e njëqind e dyzet e katër mijë e pesëqind) lekë pa TVSH.

*(me numra dhe fjalë)*

5. Op.ekonomik “**MURATI D**”sh.p.k.

K42003004T

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Vlera **4 278 000** (katër milion e dyqind e shtatëdhjetë e tetë mijë) lekë pa TVSH.

*(me numra dhe fjalë)*

6. Op.ekonomik “**MENI**”sh.p.k.

J61909018W

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Vlera **4 487 000** (katër milion e katërqind e tetëdhjetë e shtatë mijë) lekë pa TVSH

*(me numra dhe fjalë)*

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Op.ekonomik “EURO-ALB”sh.p.k.	K66613407H
2. Op.ekonomik “SARK”sh.p.k.	K52531415H
3. Op.ekonomik “PAERA”sh.p.k.	L31505034R
4. Op.ekonomik “MURATI D”sh.p.k.	K42003004T
5. Op.ekonomik “MENI”sh.p.k.	J61909018W

Përkatësisht për arsytet e mëposhtme:

\*\*\* Nga shqyrtimi i dokumentacionit administrativ ligjor të operatorit ekonomik “MENI” sh.p.k në sistemin e APP rezultoi se:

- Ka keto mangësi në kriteret e veçanta të kapacitetit teknik.

**Kriteri 2:** Në DST në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” kapaciteti teknik kriteri 2 është kërkuar:

*“Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se disponon 2 mjete kamion me kapacitet mbi 3.5 ton për transportimin e mallrave sipas nevojave të autoritetit kontraktor. Mjetet të jenë në pronësi ose me qera shoqëruar me dokumentet:*

*A. Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit a) leje qarkullimi, b) çertifikatën e kontrollit teknik (i vlefshëm), c) siguracionin e mjetit (i vlefshëm) dhe d) çertifikatën transport mallrash nga pushteti vendor (e vlefshme). Të gjitha mjetet të shoqërohen me fotografi të tyre, ku të dallohet targa dhe marka.*

*B. Për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit a) leje qarkullimi, b) çertifikatën e kontrollit teknik (i vlefshëm), c) siguracionin e mjetit (i vlefshëm) dhe d) çertifikatën transport mallrash nga pushteti vendor (e vlefshme), si dhe duhet të shoqërohet me kontratën noteriale të qerasë, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objektit të këtij prokurimi. Të gjitha mjetet të shoqërohen me fotografi të tyre, ku të dallohet targa dhe marka.”*

Op.ek “MENI”sh.p.k ka paraqitur dokumentet për dy mjete transporti, përkatësisht për mjetin në pronësi me targa TR 5607 E dhe mjetin me qera me targa KO9513B.

Nga verifikimi i dokumentave rezultoi se ka paraqitur keto dokumente për mjetin me qera me targa KO9513B:

- Kontrata qeraje nr.3635 Rep me nr.775Kol, datë 13.11.2017, e vlefshme.

- Leje qarkullimi të mjetit me qera me targa KO9513B.

- Police sigurimi nr.615, datë 22.07.2019 e vlefshme.

- Çertifikatë e kontrollit teknik e vlefshme.

- Çertifikatë e pronësisë së mjetit, leshuar në emër të “Xhengo” sh.p.k.

- Taksa vjetore e mjeteve, e vlefshme.

- Çertifikatë nr.69, datë 31.10.2016 “Për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet” të leshuar nga pushteti vendor në emër të përdoruesit “Xhengo” sh.p.k..

Në nenin 3 pikat 3.13 dhe 3.18/ “b” të ligjit Nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore” i ndyshuar përcaktohet se: “3.13 Transport për vete: **transporti i mallrave me kamion, në ardhje ose në kthim, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet.** Në këtë rast transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse e veprimtarisë kryesore, e cila vërtetohet sipas ligjeve në fuqi.

**“3.18 Certifikatë: b) dokument që i jep të drejtë një mjeti vetëm për transportin e mallrave për vete brenda dhe jashtë vendit, në përputhje me pikën 3.13 të këtij ligji”**

Në Udhëzimin Nr.20, datë 10.10.2007 “Për modelet e licencave, autorizimeve dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor” i ndryshuar është përcaktuar modeli nr.210 i Çertifikatës “Për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet” i cili në pjesën e dispozitave të përgjithshme përcakton në pikën 2 se:

*“Transporti i mallrave për llogari të vet brenda vendit: transporti i mallrave me kamion brenda vendit, në vajtje ose kthim, **vetëm për llogari të veprimtarisë së vete ndermarrjes së transportit.** Në këtë rast, transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse e veprimtarisë kryesore të ndermarrjes së transportit, **mjeti është në pronë ose me kontratë qeramarrje** i asaj ndermarrje*

*dhe drejtohet nga nje punonjes ose anetar i saj” dhe ne piken 5 percaktohet se :”Çertifikata nuk mund te transferohet nga mbajtesi i saj tek nje subjekt tjeter”.*

Operatori ekonomik “MENI” sh.p.k ka marre me kontrate qeraje me date 13.11.2017 mjetin me targa KO9513B nga qiradhenesi “XHENGO” sh.p.k, duke u bere perdorues i ketij mjeti nga data e marrjes me qera e ne vazhdim. Per rrjedhoj Çertifikata “Per transport mallrash brenda vendit per llogari te vet” e paraqitur ne dokumentat e ofertuesit, duhet te kishte si perdorues te mjetit personin juridik “MENI” sh.p.k, ndersa Çertifikata nr.69, date 31.10.2016 “Per transport mallrash brenda vendit per llogari te vet” eshte leshuar ne perdorim te subjektit juridik “XHENGO” sh.p.k.

Per sa u parashtua me siper, ofertuesi nuk e ploteson kriterin qe disponon 2 mjete kamion për transportimin e mallrave sipas nevojave te autoritetit kontraktor, pasi per mjetin me qera Çertifikata “Per transport mallrash brenda vendit per llogari te vet” nuk eshte ne emer te perdoruesit te mjetit “MENI” sh.p.k, sipas kontrates se qerese.

**Kriteri 3:** Ne DST ne shtojcen 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” kapaciteti teknik ne kriterin 3 ka kerkuar :

*“Çertifikaten ISO 9001-2015 per Sistemin e Menaxhimit te Cilesise te akredituar nga institucione shteterore vendase ose te huaja, objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme).”*

Objekti i prokurimit i kesaj procedure eshte “Blerje materiale ndertimi”, pra kemi te bejme me nje kontrate te furnizimit te mallrave, te cilat jane materiale ndertimi si: çimento, çakell, hekur, rere, gelqere, etj.

Operatori ekonomik “MENI” sh.p.k ka paraqitur ne sistem Çertifikaten EN-ISO 9001:2015 me numer 1710AL53Q per sistemin e menaxhimit te cilesise me permbajtjen sa me poshte:

*“Ndertime civile dhe industriale. Punime germimi ne toke. Rikonstruksione, mirembajtje, veshje fasadash. Ndertim rruge, autostrada, mikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale. Ndertim, ujesjellesa, gazsjellesa, vejsjellesa, vepra kullimi, vaditje. Ndertim per N/stacione kablllore e transformator, linja tensioni te larte e te mesem dhe shperndarjen e energjise. Punime per prishjen e ndertimeve, impiante ngritese dhe transportuese (ashensor, shkalle levizese), barrier e mbrojte rrugore, sinjalistike rrugore jo ndricuese, ndertime parafabrikate, b/arme metalike dhe druri. Impiante teknologjike, termike dhe te kondicionimit. Linja telefonie dhe telekomunikacioni. Impiante te brendshme elektrike, telefoni, radio telefoni, TV etj. Punime topogjeodezike.”*

Referuar permbajtjes se çertifikates ISO 9001-2015 te Operatorit ekonomik “MENI” sh.p.k nuk rezulton qe te jete çertifikuar per menaxhim te cilesise per tregtim te materialeve te ndertimit, por punime ndertimi. Nese do te bejme nje krahasim me çertifikatat ISO 9001-2015 te paraqitur nga operatoret ekonomik te tjere, pjesmarres ne kete procedure, verejme se ne permbajtjen e tyre perfshihet nder te tjera tregtimi i materialeve te ndertimit. Referuar sa me siper, objekti i çertifikates ISO 9001-2015 te operatorit ekonomik “MENI” sh.p.k nuk perputhet me objektin e prokurimit te autoritetit kontraktor. Per sa u parashtua me siper, ofertuesi nuk e ploteson kriterin 3 te kapacitetit teknik per çertifikaten ISO 9001-2015 ne perputhje me objektin e prokurimit.

**Kriteri 4:** Ne DST ne shtojcen 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” kapaciteti teknik ne kriterin 4 ka kerkuar: *“Operatoret ekonomike duhet të dëshmojë se kane nje punesim mesatar jo më pak se 6 (gjashte) punonjës per nje periudhe 6 (gjashte) mujore, perkatesisht për periudhen: tetor 2019 deri me mars 2020, te vertetuar me:*

- a. *Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, sipas periudhes se mesiperme.*
- b. *List pagesat e punonjesve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi te miratuara nga organet kompetente.*

Listëpagesat e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat

nga Punësimi për periudhën janar 2020 - mars 2020, te paraqitura nga operatori ekonomik “MENI” sh.p.k nuk janë të konfirmuara nga organet tatimore dhe as nuk janë të konfirmuar me vulën elektronike nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë.

Për sa më sipër, ofertuesi nuk ploteson kriterin 4/b të kapacitetit teknik për list pagesat e punonjësve, sipas formatit të kërkuar nga legjislacioni në fuqi të miratuar nga organet kompetente.

Operatorët ekonomike janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta, duhet të refuzohen si të papranueshme.

Në zbatim të nenit 53 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006, “Për Prokurim Publik” (të ndryshuar) “*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.....*”, për sa më sipër oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “MENI”sh.p.k shpallet e pavlefshme, pasi nuk ploteson të gjitha kriteret dhe specifikimet e kërkuara nga autoriteti kontraktor Agjencia e Sherbimeve Funerale në dokumentet e tenderit.

\*\*\* Nga shqyrtimi i dokumentacionit administrativ ligjor të operatorit ekonomik “PAERA” sh.p.k në sistemin e APP rezultojnë se:

- Ka këto mangësi në kriteret e veçanta të kapacitetit ekonomik dhe financiar.

**Kriteri 1:** Në DST në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” kapaciteti ekonomik dhe financiar kriteri 1 është kërkuar: *“Xhironja vjetore për dy vitet e fundit (2018-2019), ku vlera mesatare e të cilave të jetë jo më e ulët se vlera e fondit limit.”*

Në vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë me Nr.T02191390 datë 03.05.2020, të paraqitur nga operatori ekonomik “PAERA” sh.p.k ka të shënuar xhiron vjetore për vitin 2017 dhe vitin 2018. Për vitin 2019 rezultojnë shuma 0.

Nga krahasimi i dokumentave me operatore ekonomik të tjerë, pjesëmarrës në këto procedurë prokurimi, rezultojnë se kanë paraqitur xhiron vjetore të dy viteve të fundit (2018-2019), të gjeneruar nga sistemi me vule elektronike të tatimeve në distanca kohore shumë të afërta me datën e vërtetimit të xhiron të operatorit ekonomik “PAERA” sh.p.k.

Për sa më sipër, ofertuesi nuk ploteson kriterin 1 të kapacitetit ekonomik dhe financiar për xhiron vjetore për dy vitet e fundit 2018 dhe 2019.

- Ka këto mangësi në kriteret e veçanta të kapacitetit teknik.

**Kriteri 1:** Në DST në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” kapacitetit teknik kriteri 1 është kërkuar:

*“Furnizime të ngjashme jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit të procedurës së prokurimit, të realizuar nga operatorët ekonomik gjatë tre viteve të fundit nga data e tenderimit.*

*Per këto duhet të paraqiten;*

*- Kontrata furnizimi të ngjashme, vërtetim të lëshuar nga një ent publik dhe fatura tatimore të shitjes, ku shihen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.*

*-Kur furnizimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private, operatori ekonomik do të vërtetojë furnizimin duke paraqitur faturën tatimore të shitjes, ku shihen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.”*

Ofertuesi “PAERA” sh.p.k për kriterin nr.1 furnizime të ngjashme, ka paraqitur dokumentet si më poshtë:-Fatura tatimore nr.208, datë 08.06.2018 lidhur me “Institutin e ekzekutimeve të vendimeve penale” me objekt “material gazermimi sipas listës bashkëngjitur”. Kjo faturë nuk është e shoqëruar me listën e mallrave, nuk ka kontratë dhe nuk ka vërtetim për realizim kontrate, sipas kriterit nr.1, kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike.

-Fatura tatimore nr.001, datë 20.06.2019 lidhur me “Ndermarrja e Mirembajtjes së infrastrukturave Pogradec” me objekt “Konstruksione metalike dhe lryje me boje vaji”; -

Fature tatimore nr.142, date 03.03.2020 lidhur me “Sherbimi Informativ i Shtetit” me objekt “pajisje zyre, karrike, tavolina, televizore etj”; - Fature tatimore nr.733, date 18.02.2019 lidhur me “Drejtoria e Perqasjes Juridike Nderkombetare” me objekt “riparim automjete”; - Fature tatimore nr.732, date 15.02.2019 lidhur me “Ujesjelles Kanalizime Sha Kukes” me objekt “pjese kembimi per automjete”; - Fature tatimore nr.243, date 23.07.2018 lidhur me “Drejtoria e Sherbimit Spitalor Kurbin” me objekt “Kompjutera, printera, fotokopje”; -Fature tatimore nr.300, date 06.09.2018 lidhur me “Bashkia Gramsh” me objekt “Kondicioner”; -Fature tatimore nr.110, date 19.12.2019 lidhur me “Drejtoria Rajonale e Sherbimeve te Transportit Rrugor Shkoder” me objekt “Rafta metalike per arkiva”; - Fature tatimore nr.764, date 23.04.2019 lidhur me “Zyra Vendore e Regjistrimit te Pasurive Kavaje” me objekt “Rafta per arshive”; -Fature tatimore nr.243, date 23.07.2018 lidhur me “Drejtoria e Sherbimit Spitalor Kurbin” me objekt “Kompjutera, printera, fotokopje”, Keto fatura nuk jane te shoqeruara me kontrate dhe me vertetim per realizim kontrate, sipas kriterit nr.1, kur furnizimet e ngjashme jane realizuar me ente publike dhe objekti i ketyre faturave nuk eshte ne perputhje me objektin e prokurimit, pra nuk jane furnizime te ngjashme.

Faturat e renditura më sipër nuk janë furnizime te ngjashme me objektin e prokurimit për “Blerje materiale ndërtimi”, nuk kanë kontratë dhe vërtetim realizim kontrate, per rrjedhoje nuk plotesojne kriterin 1 te kapacitetit teknik.

-Fature tatimore nr.037, date 20.08.2019 lidhur me “Dega e Doganes Korçe” me objekt “Skare hekuri”. Kjo fature nuk eshte shoqeruar me kontrate dhe vertetim per realizim kontrate, sipas kriterit nr.1, kur furnizimet e ngjashme jane realizuar me ente publike dhe nga llogaritja rezulton qe ka ne total 69 000 Leke pa TVSH furnizime te ngjashme.-Fature tatimore nr.126, date 08.01.2020 lidhur me “Ndermarrja e Mirembajtjes se Infrastrukturave Pogradec” me objekt “Materiale inerte, granil dhe cakull”. Kjo fature nuk eshte shoqeruar me kontrate dhe vertetim per realizim kontrate, sipas kriterit nr.1, kur furnizimet e ngjashme jane realizuar me ente publike dhe nga llogaritja rezulton qe ka ne total 243 694 Leke pa TVSH furnizime te ngjashme.-Fature tatimore nr.092, date 22.11.2019 lidhur me “ Shoqeria Ujesjelles Kanalizime Sha Elbasan” me objekt “Materiale ndertimi”. Kjo fature nuk eshte shoqeruar me kontrate dhe vertetim per realizim kontrate, sipas kriterit nr.1, kur furnizimet e ngjashme jane realizuar me ente publike dhe nga llogaritja rezulton qe ka ne total 416 800 Leke pa TVSH furnizime te ngjashme.-Fature tatimore nr.74, date 10.05.2018 lidhur me “Institucioni i Ekzekutimeve Penale Lushnje” me objekt “Shtylla beton, hekur, zhavorr, rere, cemento”. Kjo fature nuk eshte shoqeruar me kontrate dhe vertetim per realizim kontrate, sipas kriterit nr.1, kur furnizimet e ngjashme jane realizuar me ente publike dhe nga llogaritja rezulton qe ka ne total 287 800 Leke pa TVSH furnizime te ngjashme.

Komisioni ka llogaritur Faturat tatimore të mësipërme duke u nisur nga furnizime që janë të ngjashme me objektin e prokurimit, pasi jo të gjitha zërat e mallrave të shënuara në faturë janë te ngjashme me objektin e prokurimit material ndertimi. Vlera e përllogaritur e këtyre faturave është në shumën 1,017,294 Leke pa TVSH.

40% e fondit limit të përllogaritur nga AK është në vlerën 1,799,224 Lekë pa TVSH.

Për sa më sipër, ofertuesi nuk plotëson kriterin për furnizime te ngjashme jo me pak se 40% te vleres se fondit limit te procedures se prokurimit.

**Kriteri 2:** Ne DST ne shtojcen 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” kapacitetit teknik kriteri 2 eshte kerkuar: “2. *Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se disponon 2 mjete kamion me kapacitet mbi 3.5 ton për transportimin e mallrave sipas nevojave te autoritetit kontraktor. Mjetet te jene ne pronesi ose me qera shoqeruar me dokumentet:*

A. *Për mjetet ne pronesi duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit a) leje qarkullimi, b) çertifikaten e kontrollit teknik (i vlefshem), c) siguracionin e mjetit (i vlefshem) dhe d) çertifikat transport mallrash nga pushteti vendor (e vlefshme). Te gjitha mjetet te shoqerohen me fotografi te tyre, ku te dallohet targa dhe marka.*

B. *Për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit a) leje qarkullimi,*

b) *çertifikaten e kontrollit teknik (i vlefshem), c) siguracionin e mjetit (i vlefshem) dhe d) certifikat transport mallrash nga pushteti vendor (e vlefshme), si dhe duhet te shoqerohet me kontratën noteriale të qerasë, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objektit te këtij prokurimi. Te gjitha mjetet te shoqerohen me fotografi te tyre, ku te dallohet targa dhe marka.”*

Operatori ekonomik “PAERA”sh.p.k në dokumentacionin shoqërues të mjetit me targa AA129IZ ka paraqitur dokumentet:

- Çertifikate pronesie të mjetit rrugor,
- Leje qarkullimi, nr.TRF0388114
- Çertifikatë e kontrollit teknik të mjeteve, e vlefshme
- Taksën vjetore të mjetit, date 01.08.2019, e vlefshme
- Policë për sigurimin nr.2529, date 30.07.2019, e vlefshme
- Mungon çertifikata *per transport mallrash nga pushteti vendor*
- Mungon foto te mjetit

Referuar lejes se qarkullimit te mjetit, rezulton se kapaciteti i mjetit është deri në 3.5 ton, ne kriterin nr.2 te kapacitetit teknik eshte kerkuar kamion me kapacitet mbi 3.5 ton, duke mos plotesuar kriterin per sa i perket kapacitetit.

Ne baze te nenit 28 te udhezimit nr.15, date 24.07.2007 “Për kriteret dhe procedurat e leshimit te licensave, autorizimeve dhe certifikatave per ushtrimin e veprimtarise ne transportin rrugor percaktohet se: “*Kamionet me kapacitet transportues nen 1500 kg nuk certifikohen per transport mallrash brenda vendit*”, nderkohe qe kapaciteti i mjetit eshte mbi 1500 kg, gjithashtu ky mjet nuk eshte kamion sipas specifikimeve te kerkuara.

- Mungon dokumentacioni per kamionin e dyte, sipas kerkes se autoritetit kontraktor.

Për sa më sipër, ofertuesi nuk plotëson kriterin 2, te kapacitetit teknik për dy mjete kamion me kapacitet mbi 3.5 ton

Operatorët ekonomike jane te detyruar te pergatisin ofertat, ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne dokumentat e tenderit dhe ofertat qe nuk pergatiten ne perputhje me keto dokumenta, duhet te refuzohen si te papranueshme.

Ne zbatim te nenit 53 pika 3 te ligjit nr.9643 date 20.11.2006, “Per Prokurim Publik” (te ndryshuar) “*Autoriteti kontraktor, ne zbatim te pikes 4 te ketij neni, vlereson nje oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit.....*”, per sa me siper oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “PAERA”sh.p.k shpallet e pavlefshme, pasi nuk ploteson te gjitha kriteret dhe specifikimet e kerkuara nga autoriteti kontraktor Agjencia e Sherbimeve Funerale ne dokumentet e tenderit.

\*\*\*Nga shqyrtimi i dokumentacionit administrativ ligjor te operatorit ekonomik “SARK” sh.p.k ne sistemin e APP rezulton se:

- Ka keto mangesi ne kriteret e veçanta te kapacitetit ekonomik dhe financiar.

**Kriteri 1:** Ne DST ne shtojcen 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” kapaciteti ekonomik dhe financiar kriteri 1 eshte kerkuar:”*Xhiroja vjetore për dy vitet e fundit (2018-2019), ku vlera mesatare e të cilave të jetë jo me e ulët se vlera e fondit limit.*”

Në vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë me Nr.T01796766 datë 06.02.2020, te paraqitur nga operatori ekonomik “SARK” sh.p.k, ka të shënuar xhiron vjetore për vitin 2016, për vitin 2017 dhe vitin 2018.

-Mungon xhiro vjetore per vitin 2019.

Nga krahasimi i dokumentave me operatore te tjere, pjesmarres ne kete procedure prokurimi, rezulton se ofertues te tjere kane paraqitur xhiron vjetore te dy viteve te fundit (2018-2019), të gjeneruar nga sistemi me vule elektronike te tatimeve.

Për sa më sipër, ofertuesi nuk ploteson kriteri 1, i kapacitetit ekonomik dhe financiar, për xhiron vjetore për dy vitet e fundit.

- Ka keto mangesi ne kriteret e veçanta te kapacitetit teknik.

**Kriteri 3:** Ne DST ne shtojcen 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” kapaciteti teknik ne kriterin 3 ka kerkuar : “*Çertifikaten ISO 9001-2015 per Sistemin e Menaxhimit te Cilesise te akredituar nga institucione shtetore vendase ose te huaja, objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme).*”

- Mungon Çertifikata ISO 9001-2015 për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë nga dokumentacioni i paraqitur nga ofertuesi “SARK” sh.p.k.
- Te kriteret e tjera ka keto mangesi.

**Ne piken 1 te “Kritereve te veçanta te Kualifikimit” te DST Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

*“Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 2/1“*

Shtojca 2/1 eshte pjese e dokumenteve standarte te tenderit, qe duhet te plotesohet nga operatori ekonomik, sipas kerkesave qe permban vete deklarata, pa ndryshuar permbajtjen e saj. Ne piken 6 deklarata ka kete permbajtje:

*”Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):*

- a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;*
- b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).*

Ofertuesi ka ndryshuar pikën 6 të deklaratës, ka hequr alternative “b” nga permbajtja e deklaratës dhe lënë vetëm alternativën “a”, ndërkohë që kërkesa është të klikohet një nga alternativat e shënuara, pa bere ndryshim (nderhyrje) te deklarates.

Pika 2 e deklarates percaktohet se: “*Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimet publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se **nuk është e plotë** dhe / ose e saktë në çdo aspekt*”, referuar kesaj pike heqja e pikes 6 shkronja “b” te deklarates nga ofertuesi, e ben kete deklarate te paplote dhe per rrjedhoj te pavlefshme dhe shkak per skualifikim.

Për sa më sipër, ofertuesi nuk permbush kriterin per paraqitjen sipas shtojcës 2/1 te DST.

Operatorët ekonomike janë të detyruar të përgatisin ofertat, në perputhje me kërkesat e percaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në perputhje me keto dokumenta, duhet të refuzohen si të papranueshme.

Ne zbatim te nenit 53 pika 3 te ligjit nr.9643 date 20.11.2006, “Per Prokurim Publik” (te ndryshuar) “*Autoriteti kontraktor, ne zbatim te pikes 4 te ketij neni, vlereson nje oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit.....*”, per sa me siper oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “SARK”sh.p.k shpallet e pavlefshme, pasi nuk ploteson te gjitha kriteret dhe specifikimet e kerkuara nga autoriteti kontraktor Agjencia e Sherbimeve Funerale ne dokumentet e tenderit.

**Konstatim per formularin e ofertes:**

Ne zbatim te neni 66 pika 4 te V.K.M nr.914, date 29/12/2014, komisioni verifikon vetem ofertat e kualifikuara, nese kane gabime aritmetikore, dhe per sa u parashtrua me siper, oferta e ofertuesit “SARK” sh.p.k eshte e pavlefshme, pasi nuk ploteson te gjitha kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor.

Megjithate komisioni ka konstatuar se oferta rezulton me gabime aritmetikore, por nuk ka derguar njoftim per arsye se kjo oferte nuk ploteson kriteret e nenit 66, pra te jete e kualifikuar si e vlefshme.Ne formularin e ofertës te ofertuesit “SARK” sh.p.k është shënuar vlera totale 4,126,000 leke pa TVSH.Nga llogatitjet e bera nga komisioni te ofertes rezulton se, vlera totale e



preventivit është në shumën 4,130,500 Lekë pa TVSH, me gabim artmetikor ne nje diference prej 4500 leke.

\*\*\*Nga shqyrtimi i dokumentacionit administrativ ligjor te operatorit ekonomik “EURO-ALB” sh.p.k ne sistemin e APP rezulton se:

- Te kriteret e tjera ka keto mangesi:

**Ne piken 1 te “Kritereve te veçanta te Kualifikimit” te DST Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

*“Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 2/1“*

Shtojca 2/1 eshte pjese e dokumenteve standarte te tenderit, qe duhet te plotesohet nga operatori ekonomik, sipas kerkesave qe permban vete deklarata. Ne piken 6 deklarata ka kete permbajtje:

*”Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):*

- a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;*
- b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).*

Ofertuesi ka perzgjedhur alternativën “b” të pikës 6 të deklaratës, sipas së cilës deklaron se është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

Nga verifikimi i dokumentave, te paraqitura nga ofertuesi ne sistem, rezulton se nuk ka bashkëlidhur asnjë document, ku te jenë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra apo shkaqet e konsultimit apo marrëveshjes. Gjithashtu nuk rezulton qe te jete bashkim operatorësh ekonomik apo te kete nenkontraktues.

Pika 2 e deklaratës percaktohet se: *“Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimet publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se **nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt**”, referuar kesaj pike mosplotesimi i te gjitha kerkesave te shkronjes “b” te pikes 6, e ben kete deklarate te paplote dhe per rrjedhoj te pavlefshme dhe shkak per skualifikimin e ofertes se ketij operatori ekonomik.*

Për sa më sipër, ofertuesi nuk permbush kriterin per paraqitjen sipas shtojcës 2/1 te DST.

Operatorët ekonomike janë te detyruar te pergatisin ofertat, ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne dokumentat e tenderit dhe ofertat qe nuk pergatiten ne perputhje me keto dokumenta, duhet te refuzohen si te papranueshme.

Ne zbatim te nenit 53 pika 3 te ligjit nr.9643 date 20.11.2006, “Per Prokurim Publik” (te ndryshuar) *“Autoriteti kontraktor, ne zbatim te pikes 4 te ketij neni, vlereson nje oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit.....”*, per sa me siper oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “EURO-ALB” sh.p.k shpallet e pavlefshme, pasi nuk ploteson te gjitha kriteret dhe specifikimet e kerkuara nga autoriteti kontraktor Agjencia e Sherbimeve Funerale ne dokumentet e tenderit.

\*\*\*Nga shqyrtimi i dokumentacionit administrativ ligjor te operatorit ekonomik “MURATI D” sh.p.k ne sistemin e APP rezulton se:

- Ka keto mangesi ne kriteret e veçanta te kapacitetit teknik

**Kriteri 2:** Ne DST ne shtojcen 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” kapacitetit teknik kriteri 2 eshte kerkuar:

*“2. Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se disponon 2 mjete kamion me **kapacitet mbi 3.5 ton** për transportimin e mallrave sipas nevojave te autoritetit kontraktor. Mjetet te jene ne pronesi*



ose me qera shoqeruar me dokumentet:

A. Për mjetet ne pronesi duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit a) leje qarkullimi, b) çertifikaten e kontrollit teknik (i vlefshem), c) siguracionin e mjetit (i vlefshem) dhe d) çertifikat transport mallrash nga pushteti vendor (e vlefshme). Te gjitha mjetet te shoqerohen me fotografi te tyre, ku te dallohet targa dhe marka.

B. Për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit a) leje qarkullimi, b) çertifikaten e kontrollit teknik (i vlefshem), c) siguracionin e mjetit (i vlefshem) dhe d) certifikat transport mallrash nga pushteti vendor (e vlefshme), si dhe duhet te shoqerohet me kontratën noteriale të qerasë, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objektit te këtij prokurimi. Te gjitha mjetet te shoqerohen me fotografi te tyre, ku te dallohet targa dhe marka.”

Nga verifikimi i dokumentave rezulton se ofertuesi ka marre me qera dy mjete me targa AA715EC dhe AA267OJ dhe ka paraqitur keto dokumente per mjetet.

Dokumentet e mjetit AA715EC:

- Kontrate qeraje nr.1190 Rep me nr.645Kol, date 02.03.2020, e vlefshme.
  - Leje qarkullimi të mjetit me qera me targa AA715EC.
  - Police sigurimi nr.1111, date 02.03.2020 e vlefshme.
  - Çertifikate e kontrollit teknik e vlefshme.
  - Çertifikate e pronesise se mjetit, leshuar ne emer te“TEVI PLAST”
  - Çertifikate nr.01, date 16.10.2017 “Per transport nderkombetar mallrash per llogari te vet” e cila eshte e vlefshme edhe per transport mallrash brenda vendit per llogari te vet, te leshuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Transportit Rrugoe, ne emer te perdoruesit “TEVI PLAST”
- Ne nenin 3 pikat 3.13 dhe 3.18/ “b” te ligjit Nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore” i ndyshuar percaktohet se: “3.13 Transport për vete: **transporti i mallrave me kamion, në ardhje ose në kthim, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet.** Në këtë rast transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse e veprimtarisë kryesore, e cila vërtetohet sipas ligjeve në fuqi.

“3.18 **Certifikatë: b) dokument që i jep të drejtë një mjeti vetëm për transportin e mallrave për vete brenda dhe jashtë vendit, në përputhje me pikën 3.13 të këtij ligji**”.

Ne Udhëzimin Nr.20, datë 10.10.2007 “Për modelet e licencave, autorizimeve dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor” i ndryshuar eshte percaktuar modeli nr.212 i Çertifikates “Per transport nderkombetar mallrash per llogari te vet” i cili ne pjesen e dispozitave te pergjithshme percakton ne piken 2 se:

“**Transporti i mallrave per llogari te vet brenda vendit: transporti i mallrave me kamion brenda vendit, ne vajtje ose kthim, vetem per llogari te veprimtarise se vete ndermarrjes se transportit.** Ne kete rast, transporti eshte vetem nje veprimtari ndihmese e veprimtarise kryesore te ndermarrjes se transportit, **mjeti eshte ne prone ose me kontrate qeramarrje i asaj ndermarrje dhe drejtohet nga nje punonjes ose anetar i saj**”.

dhe ne piken 6 percaktohet se :”**Çertifikata nuk mund te transferohet nga mbajtési i saj tek nje tjeter**”.

Operatori ekonomik “MURATI D” sh.p.k ka marre me kontrate qeraje mjetin me targa AA715EC nga qiradhenesi “TEVI PLAST”, duke u bere perdorues i ketij mjeti nga data e marrjes me qera e ne vazhdim. Per rrjedhoj Çertifikata “Per transport nderkombetar mallrash per llogari te vet” e paraqitur ne dokumentat e ofertuesit, duhet te kishte si perdorues te mjetit personin juridik “MURATI D” sh.p.k, ndersa Çertifikate nr.01, date 16.10.2017 “Per transport nderkombetar mallrash per llogari te vet”eshte ne emer te perdoruesit “TEVI PLAST”

Dokumentet e mjetit AA267OJ:

- Kontrate qeraje nr.1192 Rep me nr.647Kol, date 02.03.2020, e vlefshme.
- Leje qarkullimi të mjetit me qera me targa AA267OJ.
- Police sigurimi nr.344, date 05.09.2019 e vlefshme.
- Çertifikate e kontrollit teknik e vlefshme.
- Çertifikate e pronesise se mjetit, leshuar ne emer te“FRUTIBEST” sh.p.k

- Çertifikate nr.02, date 14.09.2016 “Per transport nderkombetar mallrash per llogari te vet” e cila eshte e vlefshme edhe per transport mallrash brenda vendit per llogari te vet, te leshuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Transportit Rrugoe, ne emer te perdoruesit “FRUTIBEST”sh.p.k Arsyetimi ne lidhje me Çertifikate nr.02, date 14.09.2016 “Per transport nderkombetar mallrash per llogari te vet” per mjetin AA267OJ eshte i njejte me arsyetimin e bere me siper per mjetin AA715EC.

Per sa u parashtrua me siper, ofertuesi nuk e ploteson kriterin 2, qe disponon 2 mjete kamion për transportimin e mallrave sipas nevojave te autoritetit kontraktor, pasi per keto mjete me qera, Çertifikata “Per transport nderkombetar mallrash per llogari te vet” nuk jane ne emer te perdoruesit te mjetit “MURATI D” sh.p.k, sipas kontrates se qerese, por ne emer te qiradhenesve.

- Ka plotesuar te gjitha kriteret e tjera:

Operatoret ekonomike jane te detyruar te pergatisin ofertat, ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne dokumentat e tenderit dhe ofertat qe nuk pergatiten ne perputhje me keto dokumenta, duhet te refuzohen si te papranueshme.

Ne zbatim te nenit 53 pika 3 te ligjit nr.9643 date 20.11.2006, “Per Prokurim Publik” (te ndryshuar) “*Autoriteti kontraktor, ne zbatim te pikes 4 te ketij neni, vlereson nje oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit.....*”, per sa me siper oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “MURATI D” sh.p.k shpallet e pavlefshme, pasi nuk ploteson te gjitha kriteret dhe specifikimet e kerkuara nga autoriteti kontraktor Agjencia e Sherbimeve Funerale ne dokumentet e tenderit.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, Operatorin ekonomik “**SHPRESA-AL**”sh.p.k. Adresa: Njësia Bashkiake Nr.9, Rruga "Urani Pano", mbrapa "Veve Center", Pallati Nr.11, Kati 2, e-mail: [shpresa.al@gmail.com](mailto:shpresa.al@gmail.com) se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **3 929 500** (tre milion nëntëqind e njëzet e nëntë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH/ pikët totale të marra [\_\_\_\_\_]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Agjencisë së Shërbimeve Funerale me adresë:Rr.Durrësit, nr.132, Tiranë* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 7 (shtatë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 13.05.2020

Ankesa: Nuk ka patur ankesa.

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Raimonda Shino**

